Kriteri : 4.7.1.2, 4.7.1.4, 4.7.1.5, 4.7.1.6, 4.7.1.7,4.7.1.8. 4.7.1.9. 4.7.1.12.

- Mungesa e vazhdueshmërisë së përdorimit të metodologjisë së mësimdhënies, ku përfshihen metoda, teknika dhe strategji reflektohet në mospërbushjen e arritjeve , pritshmërive dhe rezultateve të të nxënit.

Nënfusha 4.8. Detyrat e shtëpisë

Treguesi : 4.8.1. Mësuesi/instruktori planifikon detyrat e shtëpisë si vazhdim i procesit të nxënies së pavarur individuale ose në grup.

Kriteret: 4.8.1. 3.;4.8.1.4;4.8.1.5;4.8.1.6; 4.8.1.7.

- Detyrat e shtëpisë jepen në mënyrë përgjithësuese pa iu përshtatur nivelit të nxënësve.
- Mungesa e herëpas'herëshme e detyrave individuale që zhvillojnë aspektin krijues të nxënësve.

Nënfusha 4.9. Përsëritja

Treguesi: 4.9.1. Mësuesi/instruktori realizon një përsëritje efektive me në qendër nxënësin/kursantin.

Kriteri : 4.9.1.5;4.9.1.6;4.9.1.7.

- Ndodh që në orët e përsëritjes të mos i kushtohet vëmendja e duhur anës cilësore.

Nënfusha 4.11. Nxënësit/ kursantët me nevoja të veçanta

Treguesi : 4.11.1. Procesi mësimor mbështet nxënësit/kursantët me nevoja të veçanta.

- Parashikimi i pamjaftueshëm i rezultateve të të nxënit për nxënësit me nevoja të veçanta referuar aftësive të tyre.
- Rastet e nxënësve me nevoja të veçanta ku produktet krijuese të tyre nuk janë promovuar siç duhet.

Fusha 5 : Vlerësimi

Performanca e vetëvlerësimit Shumë mirë 1.30

Vetëvlerësimi sipas nënfushave

Nr	Nënfusha	Nivelet e vlerësimit	Pikët
1	Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit	Shumë mirë	1.4
2	Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit	Shumë mirë	1.0
3	Procesi i vlerësimit	Mirë	1.9
4	Arritjet	Mirë	1.5
5	Rivlerësimi	Shumë mirë	1.0
6	Ankimimet	Shumë mirë	1.0
	VLERËSIMI PËR FUSHËN 5	SHUMË MIRË	1.30

Vetëvlerësimi sipas treguesve

Nënfusha	Treguesi	Nivelet e vlerësimit	Pikët
1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit	1.1. Mësuesi instruktori dokumenton vlerësimin për të nxënë të nxënësit/kursantit	Mirë	1.6
	1.2. Mësuesi/instruktori zhvillon vlerësime me test/detyra përmbledhëse për të matur nivelin a rritjeve të nxënësity/kursantit	Shumë mirë	1.3

	1.3. Mësuesi/instruktori realizon vlerësim të nxënësit/kursantit duke u bazuar në portofilin e tij.		
2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/ Kursantit	2.1. Mësuesi/instruktori kryen vlerësimin përfundimtar të nxënësit/kursantit	Shumë mirë	1.0
	2.2. Mësuesi/instruktori vlerëson nxënësit në Provimet Përfundimtare të Nivelit I, II dhe III në Arsimin Profesional.	Shumë mirë	1.0
3. Procesi i vlerësimit	3.1. Mësuesi/instruktori ka një program të qartë për vlerësimin e nxënësve/kursantëve.	Mirë	2.0
	3.2. Mësuesi/instruktori bën vlerësimin e nxënësve/kursantëve për qëllime të ndryshme.	Mirë	1.6
4. Arritjet	4.1. Rezultatet e nxënësve në Maturën Shtetërore përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga shkolla e AFP.	Mirë	2.0
	4.2. Rezultatet e nxënësve/kursantëve në Provimet Përfundimtare të Niveleve/Kurseve të unifikuara I, II dhe III në AFP, përputhen me vlerësimin e bërë gjatë procesit dhe vitit mësimor	Shumë mirë	1.2
	4.3. Mësuesi/instruktori informon prindërit për rezultatet e nxënësve dhe kursantëve	Mirë	1.5
5. Rivlerësimi	5.1. IoAFP-ja zhvillon procedura rivlerësimi për nxënësit/kursantët konform akteve ligjore.	Shumë mirë	1.0
6. Ankimimet	6.1. IoAFP-ja u përgjigjet ankimimeve të nxënësve/kursantëve për vlerësimin e tyre.	Shumë mirë	1.0

➤ GJETJET

(Pika të forta)

Nënfusha: 5.1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit

Treguesi: 5.1.2. Mësuesi/instruktori zhvillon vlerësime me test/detyra përmblendhëse për të matur nivelin a rritjeve të nxënësit/kursantit

- Vlerësimi periodik i nxënësit zhvillohet si një proces në vazhdimësi duke përfshirë vlerësimin e vazhduar dhe me teste përmblendhëse duke u mbështetur në kërkesat zyrtare.

Nënfusha: 5.2. Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit

Treguesit : 5.2.1, . Mësuesi/instruktori kryen vlerësimin përfundimtar të nxënësit/kursantit

5.2.2. . Mësuesi/instruktori vlerëson nxënësit në Provimet Përfundimtare të Nivelit I, II dhe III në Arsimin Profesional.

- Vlerësimet përfundimtare në fund të vitit shkollor si edhe ato të provimeve përfundimtare profesionale të niveleve realizohen duke zbatuar me përpikmëri udhëzimet zyrtare të MAS dhe AKAFPK –së.

Nënfusha:5.4. Arritjet

Treguesi 5.4.2. Rezultatet e nxënësve në Provimet Përfundimtare të Niveleve

I, II dhe III në AFP, përputhen me vlerësimin e bërë gjatë procesit dhe vitit mësimor.

- Analiza e rezultateve të provimeve përfundimtare profesionale të niveleve tregon një përputhshmëri të vlerësimeve gjatë procesit mësimor vjetor me vlerësimet e provimeve përfundimtare.

Nënfusha:5.5. Rivlerësimi

Treguesi :5.5.1. IoAFP-ja zhvillon procedura rivlerësimi për nxënësit/kursantët konform akteve ligjore.

- Në veprimtarinë e saj shkolla vazhdimisht analizon dhe zbaton procedurat për rivlerësimin e nxënësve.

(Pika për përmirësim)

Nënfusha :5.1. Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit

Treguesi: 5.1.1. Mësuesi/instruktori dokumenton vlerësimin për të nxënë të nxënësit/kursantit

- Vlerësimi i vazhduar i nxënësve bazohet në një program të qartë , por jo gjithmonë përdoret shumëllojshmëria e metodave për një vlerësim sa më objektiv të tyre.

Nënfusha: 5.3. Procesi i vlerësimit

Treguesi :5.3.1. Mësuesi/instruktori ka një program të qartë për vlerësimin e nxënësve.

5.3.2. Mësuesi/instruktori bën vlerësimin e nxënësve për qëllime të ndryshme.

- Jo gjithmonë zbatohet shumëllojshmëria e metodave për një vlerësim sa më objektiv të nxënësit

Nënfusha:5.4. Arritjet

Treguesi :5.4.1. Rezultatet e nxënësve në Maturën Shtetërore përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga shkolla e AFP.

- Përputhshmëria e rezultateve përfundimtare të shkollës me ato të maturës shtetërore nuk ka funksionuar/përputhur në të tre nivelet e arritjes së nxënësve.

Treguesi: 5.4.3. Mësuesi/instruktori informon prindërit për rezultatet e nxënësve dhe kursantëve.

- Raportimi i arritjeve të nxënësve bëhet rregullisht në lidhje me vlerësimet e tyre por vetëm me notë.

➤ GJYKIME DHE KONKLUZIONE

Procesi i vetëvlerësimit u karakterizua nga një punë voluminoze,gjithëpërfshirëse,thelbësore kjo për faktin e kryerjes së procesit të optimizimit ndërmjet shkollës Profesionale “Beqir Çela” dhe Shkollës Profesionale “26 Marsi”.

Gjatë procesit u hasën vështirësi për standartizimin e procedurave për vlerësimin sa më real dhe gjithëpërfshirës të këtij procesi.Gjithashtu u konstatuan një sërë situatash të padokumentuara dhe të parealizuara konform kërkesave , udhëzimeve dhe ligjeve në fuqi, të cilat sollën vështirësi për ekipin e Vetëvlerësimit të brendshëm të shkollës për unifikimin e gjithë procedurës dhe nxjerrjen e rezultateve sa më reale . Vetëvlerësimi i brendshëm i shkollës pasqyroi ecurinë e institucionit duke përfshirë arritjet dhe mosarritjet brenda vitit 2023-2024. Gjatë këtij vetëvlerësimi rezultatet e përftuara analizojnë më së miri punën e kryer nga të gjithë organizmat e shkollës dhe stafi i saj për ruajtjen e cilësisë dhe rritjen e standarteve .Fusha ku shkolla vlerëson që duhet të bëjë një punë më të madhe për përmirësimin e rezultateve është “mësimdhënia dhe të nxënësit “, për të cilën ka përgatitur planin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë për periudhën Shkurt- Qershor 2025.

Plani i përmirësimit të cilësisë përfshin jo vetëm mësimdhënien dhe të nxënët por të gjitha fushat e nënfushat ku shkolla ka konstatuar nevojë për ndërhyrje dhe përmirësim të situatës. Performanca institucionale për vitin 2023-2024 është realizuar me 1.36 pikë e cila i korespondo vlerësimit Shumë mirë, çka reflekton edhe njëherë performancën e lartë që shkolla ka e cila përputhet edhe me procesin e Akreditimit si vlerësim “Akreditimi i plotë” për të gjitha kualifikimet profesionale.

Përsa më sipër Shkolla Profesionale “ Beqir Çela “ garanton standartet dhe cilësinë, si institucion me vlera dhe imazh të mirë në aspektin Kombëtar dhe Ndërkombëtar në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional.

1. F1 Menaxhimi dhe drejtimi

Funksionimi i institucionit është mbështetur në zbatimin e ligjeve, udhëzimeve, rregulloreve, kritereve dhe orientimeve që burojnë nga kuadri ligjor .

Gjatë procesit të vetëvlerësimit të institucionit është konstatuar që në Menaxhim dhe drejtimin institucional janë përfshirë të gjithë organizmat dhe aktorët që janë pjesë e funksionit të institucionit. Veprimtaria dhe puna e tyre ka qënë e koordinuar me ekipet lëndore, departamentet dhe Njësinë e Zhvillimit.

Kujdes i veçantë i është kushtuar mësimdhënësve të rinj në shkollë për mbështetjen e tyre në të gjithë veprimtarinë e tyre .

Stafi drejtues ka nxitur dhe reklamuar punën për promovimin dhe regjistrimin e nxënësve në klasat e X^{ta}.

Me efektivitet të lartë ka përdorur burimet financiare në mbështetje të veprimtarisë së procesit mësimor në shkollë si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore .

Kërkesat e vazhdueshme të shkollës për mësimdhënës të rinj për teorinë dhe praktikën profesionale kërkon përmirësimin e vazhdueshëm në planifikimin dhe mbështetjen dhe zhvillimin e tyre profesional.

2. F2 Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi

Bashkëpunimi me organet e qeverisjes qendrore, vendore dhe rajonale, është një nga faktorët kryesorë mbështetës në veprimtarinë e shkollës.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm i shkollës me komunitetin e biznesit ka luajtur një rol të rëndësishëm për përgatitjen profesionale të nxënësve .

Zhvillimi i dhe hapja e vazhdueshme e bizneseve të reja në rajon kërkon evidentimin të tyre nga shkolla.

Pjesë e rëndësishme në organizmat vendimmarrës të shkollës është komuniteti i prindërve.

Përfshirja e tyre në bashkëpunim me shkollën për studimin dhe anaizën për nevojat e tregut të punës do të ndihmonte për një evidentim më të plotë të bizneseve.

Veprimtaria e Njësisë së Zhvillimit ka ndikuar në rritjen e performancës dhe nivelit të cilësisë në shkollë.

3. F3 . Kurrikula e zbatuar

Institucioni ynë në zbatimin e kurrikulës është mbështetur dhe ka funksionuar në përputhje me të gjitha kriteret rregullat dhe udhëzimet e M.A.S, M.E.K.I dhe AKAFPK – së

Njësisë së zhvillimit dhe ekipi kurrikular ka mundësuar zbërthimin hartimin dhe zbatimin e skeletkurrikulave të formimit të përgjithshëm dhe atij profesional në hartimin e planeve të mësimdhënies së teorisë dhe të praktikës profesionale.

Mësuesit planifikojnë tema ndërkurrikulare në lëndët e tyre por nuk përfshijnë të gjithë aktorët që ndikojnë në performancën e institucionit.

Mungesa e teksteve të të mirëfillta për teorinë dhe praktikën profesionale si dhe mjetet didaktike dhe baza materiale të amortizuara dhe të pamjaftueshme kanë ndikuar në rezultatet e të nxënësve . Përgatitja shkencore dhe aftësitë teoriko – praktike profesionale të mësimdhënësve si dhe klima pozitive dhe marrdhëniet midis tyre ka ndihmuar në zbatimin korrekt të saj .

Organizimi dhe zhvillimi i provimeve të nxënësve në të gjitha kualifikimet , me profesionalizëm dhe korrektësi.

4. F4. Mësimdhënia dhe të nxënësve

Proçesi e mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollë është zhvilluar në përputhje me planet lëndore vjetore në të cilët është përcaktuar dhe arritja e rezultateve të të nxënësve.

Formimi shkencor i mësimdhënësve është pasqyruar në orën mësimore ku vlen të theksohet se zbatohen parimet kryesore të mësimdhënies; Komunikimi i ngrohtë dhe pozitiv mësues nxënës , gjithëpërfshirja, diversiteti, puna krijuese si dhe zhvillimi i aftësive të buta.

Planifikimi i detyrave të shtëpisë si vazhdim i proçesit të të nxënësve individual nuk nxit nivelin krijues të të nxënësve si implementimi i teknologjisë apo i gjetjeve të modeleve nga jeta e përditshme.

Mjediset e sigurta të institucionit (Durrës dhe Kavajë) kanë ndikuar në rritjen e besimit dhe interesit ndaj shkollës, reflektuar kjo edhe në regjistrimet e nxënësve për herë të parë.

5. F5. Vlerësimi

Për një vlerësim dhe vetëvlerësim objektiv të nxënësve përdoren instrumenta e metoda të larmishme.

Vlerësimi objektiv përfundimtar në përmbushjen e kompetencave profesionale të kualifikimeve që afrojnë shkolla, i ka shërbyer hartimi i testeve të provimeve profesionale të niveleve dhe organizimi i tyre .

Përfaqësuesit e bizneseve kanë qënë pjesë e komisioneve për vlerësimin e nxënësve në praktikën profesionale në biznese dhe në provimet përfundimtare të niveleve. Kjo i ka shërbyer një vlerësimi profesional të nxënësve.

Komunikimi dhe informimi sistematik me prindërit ka ndihmuar në rritjen e rezultateve të nxënësve.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve bëhet duke përdorur metoda të ndryshme vlerësimi . Është i nevojshëm përmirësimi dhe pasurimi i vazhdueshëm i këtyre metodave.

Gjatë procesit të Vetëvlerësimit të brendshëm, nga gjetjet e përfituara arritëm në konkluzionin që institucioni në tërësi ka performuar brenda kuadrit ligjor duke pasqyruar rezultate të kënaqshme në gjithë funksionimin e tij.

➤ VLERËSIMI

Bazuar në raportet e përpunuara nga platforma digjitale, *scvet.al*, të të 5 fushave, përfituam vlerësimin përfundimtar të shkollës si më poshtë:

FUSHA	NIVELET E VLERËSIMIT	PIKËT 2024-2025
<i>F.1. Menaxhimi dhe drejtimi</i>	<i>Shumë mirë</i>	<i>1.16</i>
<i>F.2. Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi</i>	<i>Shumë mirë</i>	<i>1.45</i>
<i>F.3. Kurrikula e zbatuar</i>	<i>Shumë mirë</i>	<i>1.35</i>
<i>F.4. Mësimdhënia dhe të nxënësit</i>	<i>Mirë</i>	<i>1.52</i>
<i>F.5. Vlerësimi</i>	<i>Shumë mirë</i>	<i>1.30</i>
VLERËSIMI INSTITUCIONAL (SHKOLLA)	SHUMË MIRË	1.36

SHKOLLA PROFESIONALE “BEQIR ÇELA”:

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM PËR TË 5 FUSHAT ËSHTË:

PERFORMANCA E VETËVLERËSIMIT

SHUMË MIRË 1.36

➤ REKOMANDIME

- ✓ *Të vijojë unifikimi dhe standartizimi i menaxhimit të dokumentacionit pas procesit të optimizimit, deri në qershor 2025.*
- ✓ *Të kryhen në vazhdimësi trajnime profesionale të stafit mësimor dhe atij mbështetës të ofruara nga shkolla, donatorët dhe në mënyrë individuale, deri në dhjetor 2025.*
- ✓ *Shkolla të angazhohet në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për shëndetësinë që të mundësohet mobilimi i dhomës së mjekut dhe dhomës dentare me pajisjet profesionale dhe të garantohet një mjek dhe një dentist për shkollën për gjatë vitit 2025.*
- ✓ *Shkolla të vazhdojë bashkëpunimin me qeverisjen vendore për përfshirjen në projekte të ndryshme dhe ndihmën e nxënësve në nevojë, gjatë vitit 2025.*
- ✓ *Të vazhdojë intensifikimi dhe unifikimi i aspekteve ligjore për bashkëpunimin me komunitetin e biznesit dhe me shoqërinë civile, përgjatë vitit 2025.*

- ✓ *Shkolla angazhohet për të gjetur ura bashkëpunimi me institucionet analoge brenda dhe jashtë vendit brenda vitit 2025.*
- ✓ *Mësuesit /instructorët ndërtimin e planit ditor ta bazojnë në përfshirjen e të gjithë elementëve strukturorë , gjithpërfshirjes dhe punën e diferencuar me nxënësit. Shkurt-Qershor 2025*
- ✓ *Mësuesit /instructorët në planin ditor të konkretizojnë përfshirjen e aftësive ndërkurrikulare , aftësive të buta , aftësive të gjelbra dhe digitale në periudhën shkurt - qershor e vazhdimësi. Shkurt-Qershor 2025*
- ✓ *Mësuesit të përdorin në çdo orë mësimore mjetet didaktike mësimore si dhe teknologjinë e informacionit për mbështetjen e nxënësve dha arritjen e rezultateve. Shkurt-Qershor 2025.*
- ✓ *Mësuesit në çdo rast të vlerësimit të nxënësve duhet të informojnë prindërit dhe nxënësit për metodologjinë e përdorur dhe rezultatet e arritura. Shkurt-Qershor 2025.*
- ✓ *Mësuesit dhe koordinatori i orientimit në karrierë të konkretizojnë mënyrat dhe afatet e procesit të këshillimit të nxënësve në karriërë me focus rritjen e numrit të vajzave, gjatë vitit 2025.*

PLANI I PËRMIRËSIMIT TË VAZHDUESHËM TË CILËSISË

PËR PERIUDHËN : SHKURT- QERSHOR 2025

FUSHA E VETËVLERËSIMIT : Menaxhimi dhe drejtimi

REKOMANDIMI 1		Të vijojë unifikimi dhe standartizimi i menaxhimit të dokumentacionit pas procesit të optimizimit .				
Objektivi		<i>-Të menaxhohet në kohë reale dokumentacioni institucional. (Durrës-Kavajë)</i>				
Treguesi i përmbushjes: Të gjitha drejtimet profesionale të kenë rrjetet e tyre.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Përfshirja e të gjithë aktorëve institucionalë (Financa, burimet njerëzore, Juristja, sekretarja, stafi drejtues etj.)	Deri Qershor 2025	Drejtoria e shkollës	Vëzhgime, pasqyrime, raporte Analiza	Dosjet me të gjitha të dhënat	Durrës - Kavajë

REKOMANDIMI 2		<i>Shkëmbimin e përvojës së trajnimit dhe të kualifikimit të personelit.</i>				
Objektivi		<i>-Të jemi pjesë e vazhdueshmenë rrjetet profesionale duke shkëmbyer përvojat tona me koordinatorin e ZVA</i>				
Treguesi i përmbushjes: Të gjitha ekipet lëndore të kulturës së përgjithshme të jenë të përfshira në rrjetet profesionale të ZVA në mënyrë që mësuesit të përditësohen me të rejtat me zbatimin e skeletkurrikulës dhe gjithçka rrjedh prej saj.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Takime të drejtëpërdrejta me kryetarët e ekipeve lëndore me përfaqësuesin e ZVA	Mars 2025	Kryetarët e ekipeve	Takim i drejtëpërdrejtë	listëprezenca	ZVA Shkollë
2	Krijimi i grupeve sipas kualifikimeve profesionale me focus pjesmarrja e tyre në takime të drejtëpërdrejta dhe online dhe përzgjedhja e mësuesit coordinator për shkollën.	Mars 2025	Ekipet lëndore	Takim i drejtëpërdrejtë. Instrument matës, pyetësor.	Dosje listëprezenca	Shkollë

REKOMANDIMI 3		<i>Pajisja e ambjenteve te dhomes mjekut dhe dentistit me mjetet e posaçme profesionale.</i>				
Objekti		<i>Ngritja e ekipit shëndetësor në shkollë</i>				
Treguesi i përmbushjes: Të gjitha drejtimet profesionale të kenë rrjetet e tyre.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Takim me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë	Prill 2025	Drejtori	Takim i drejtëpërdrejtë		Shkollë

FUSHA E VETËVLERËSIMIT : Marrdhëniet dhe bashkëpunimi

REKOMANDIMI 1		-Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin e biznesit				
Objekti		<i>-Të forcojmë bashkëpunimin midis shkollës dhe komunitetin e biznesit duke krijuar marrveshje të reja bashkëpunimi</i>				
Treguesi i përmbushjes: Lista e bizneseve aktiv të të gjitha kualifikimeve që bashkëpunojnë me shkollën.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Takime , vëzhgime, bashkëbisedime , intervista me përfaqësues të bizneseve.	Shkurt – maj 2025	P.B.Prodhuese Koord.Biznesit në njësinë e zhvillimit	Vizita në teren	Përpunim të dhënash Relacione, analiza	Teren Shkollë
2	1.Feedback nga Bizneset që veprojnë në rajon . 2.Evidentimi nëpërmjet QKR të bizneseve të reja në rajonin tonë.	Mars–Qershor 2025	Pergj B.prodhuese Koord Biznesit në Njësi	Online	Përpunim të dhënash	Shkollë -Biznes

REKOMANDIMI 2		-Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile				
Objekti		<i>-Të identifikojmë vazhdimisht organizatat OJF në rajonin tonë</i>				
Treguesi i përmbushjes: Lista e organizatave të shoqërisë civile						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	1.Takime , vëzhgime, bashkëbisedime , intervista me shoqërinë civile. 2. Evidentimi i plotë i OJF në rajonin tonë.	Deri qershor 2025	Psikolog Koord karrieres Marketingut	Vizita në teren	Përpunim të dhënash Relacione, analiza	Teren Shkollë
2	Tema:”Diversiteti në shoqërinë tone”	Shkurt	Psikologu i	Diskutim i	Pyetësor	Qëndr

	Fokus grupe	2025	shkollës	lirë + pyetësor	Përpunim të dhënash	a komun itare multif unksio nale
3	Tema:”Shkaqet dhe pasojat e përdorimit të adoleshecës	Mars 2025	Psikologu i shkollës	Informuese Sensibilzues Ndërgjegjësuese Diskutim	Pyetësor Përpunim të dhënash	Teren - shkollë

REKOMANDIMI 3		Mësuesit dhe koordinatori i orientimit në karrierë të konkretizojnë mënyrat dhe afatet e procesit të këshillimit të nxënësve në karriëre me focus rritjen e numrit të vajzave, gjatë vitit mësimor 2025-2026.				
Objektivi		<i>-Të forcojmëpunën edhe veprimtaritë e këshillimit në karrierë për rritjen e numrit të nxënësve në shkollë me focus rritjen e numrit të vajzave.</i>				
Treguesi i përmbushjes: Rritja me 8 % numrit të nxënësve në shkollë , Rritja me 50 % i numrit të vajzave të viti më parë.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrument i matës	Vendn dodhja
1	Takim me nxënësit e klasave të IX-ta në shkolla të rajonit për edukimin dhe barazinë gjinore .	Mars-maj 2025	Grupete promovimit Psikologe shkollës Koord Edukimit në karrierë mesues	Vizita në teren	Përpunim të dhënash Relacione, analiza	Shkolla 9-vjeçare të rajonit
2	Takim me prinder të shkollave 9-vjeçare të rajonit tonë	Maj 2025	Ekipet e promovimit në shkollë	Takime të drejtëpërdre jta me vizita në shkollë	Relacione Analiza	Shkollat 9 - vjecare
3	Takim me mësues dhe drejtues të shkollave 9-vjeçare të rajonit tonë	Maj 2025	Ekipet e promovimit në shkollë	Takime të drejtëpërdre jta me vizita në shkollë	Relacione Analiza	Shkollat 9 - vjecare

REKOMANDIMI 4		Shkolla bashkëpunon me institucione analoge , institucione të arsimit post sekondar dhe atij të lartë për zhvillimin profesional të saj.				
Objektivi		<i>Të forcojmë bashkëpunimin me arsimin postsekondar dhe institucionet e AL për përmirësimin e kurrikulave, materialeve mësimore mbështetëse dhe aftësimin profesional të nxënësve për përgatitjen profesionale të tyre.</i>				

Treguesi i përmbushjes: Marrëveshje bashkëpunimi me UPT,UAMD, U.BARLETI, U.EPOKA, U.POLIS.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Takime me përfaqësues të Arsimit Lartë (UPT, Universiteti Barleti, Epoka, Polis, etj)	Maj - Qershor 2025	Drejtoria	Biseda të hapura , diskutime	Relacion përmbledhës	Shkollë - Universitet
2	Trajnime të mësimdhënësve në bashkëpunim me Universitetin Barleti.	Gjatë vitit 2025	Drejtoria	Trajnim online i certifikuar	Çertifikata të mësuesve	Shkollë Universitet
3	Vizitë studimore e shkëmbim eksperience me shkollën Profesionale “Petro Sota” Fier dhe Industriale Vlorë.	Prill – Maj 2025	Stafi mësimdhënës Drejtoria	Vizitë në shkolla	Vizitë	Fier-Vlore
4	Takime me përfaqësues të Arsimit PS (UAMD)	Qershor 2025	Drejtoria	Biseda të hapura , diskutime	Relacion përmbledhës	Shkollë - UAMD

FUSHA E VETËVLERËSIMIT : Kurrikula e zbatuar

REKOMANDIMI 1		Hartimi i planit ditor me të gjithë dokumentet që përcakton korniza kurrikulare dhe udhëzimet që burojnë nga ajo.				
Objektivi		<i>-Të parashikohet gjithmonë situata e të nxënësve, vlerësimi dhe vetëvlerësimi si dhe detyrat e diferencuara.</i>				
Treguesi i përmbushjes: Materialet mësimore të drejtimeve që ofron shkolla						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumenti matës	Vendndodhja
1	Vëzhgime të herëpashershme duke përdorur strategji të ndryshme, diskutime , fotoçasti , speed - dating dhe përcaktimi i fokuseve specifike.	Shkurt Qershor 2025	Stafi drejtues i shkollës	Vëzhgime në klasë	Instrumenti i vëzhgimit	Shkollë
2	Orë të hapura mësimore,	Shkurt – Qershor 2025	Ekipi lëndor	Zhvillimi në kohë reale	Ditaret	shkollë
3	Pyetësorë me nxënës e mësues	Shkurt – Qershor 2025	Ekipi kurrikular	Link	Dosje	Shkollë

REKOMANDIMI 2		-Përmirësimi i vazhdueshëm i zhvillimit të aftësive dhe temave ndërkurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies.				
Objektivi		<i>-Të forcojmë bashkëpunimin midis mësimdhënësve në shkollë për realizimin e projekteve ndërkurrikulare. -Të përfshihen prindërit në hartimin e projekteve ndërkurrikulare</i>				
Treguesi i përmbushjes: Të paktën në çdo lëndë të ketë një projekt ndërkurrikular me ndërthurjen e disa lëndëve.						

Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrument i matës	Vendnd odhja
1	Takim midis mësimitdhënësve të shkollës për bashkëpunim mes tyre për projektet ndërkurikulare me fokus : Aftësitë e gjelbra dhe digjitale , matematikore si dhe të komunikimit.	Prill 2025	Mësimdhënës dhe drejtues ekipeve dhe departam enteve	Takime të drejtëpërdrejta Pyetësorë kërkime	Gjetje, sugjerime, materiali përmbledh es kurrikular.	Shkollë
2	Takim i drejtëpërdrejtë me këshillin e prindërve	Shkurt 2025	Ekipi kurrikular	Takime të drejtëpërdrejta	Gjetje, sugjerime, materiali përmbledh es kurrikular	Shkollë
REKOMANDIMI 3		Vënia në efikasitet të laboratorëve dhe klasave mësimore të teorisë profesionale me bazën materiale dhe <i>didaktike</i> mësimore. (<i>Shënim: ky rekomandim i vlefshëm edhe për 4.5.2.</i>)				
Objektivi		<i>-Të pajisen laboratorët e teorisë profesionale me bazën materiale për të mundësuar zhvillimin e procesit mësimor.</i>				
Treguesi i përmbushjes: Materiali mësimor për çdo lëndë e modul profesional .						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrument i matës	Vendnd odhja
	Takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e MEKI dhe GIZ për plotësimin e nevojave të bazës materiale në laboratorë.		Kryetarët e departam enteve			
1	Përgatitja dhe miratimi i materialeve shkencore të domosdoshme për lëndët e teorisë dhe të praktikës profesionale nga mësimitdhënësit përkatës të cilat nuk janë në faqen zyrtare të AKAFPK.	Gjatë vitit 2024	Mësimdhënësit	Punë e pavarur individuale dhe bashkëpunu ese në ekip	Materialet e shtypura	Shkollë

FUSHA E VETËVLERËSIMIT : Mësimdhënia dhe të nxënit

REKOMANDIMI 1		Përmirësimi i vazhdueshëm i punës për hartimin i planit mësimor si kusht i domosdoshëm për arritjen e rezultateve mësimore në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie.				
Objektivi		<i>-Të përmirësohet edhe më tej puna për hartimin i planit mësimor si kusht i domosdoshëm për arritjen e rezultateve mësimore në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie.</i> <i>-Të hartohet plani mësimor bazuar në nivelin e klasës.</i>				
Treguesi i përmbushjes: 100% e mësimitdhënësve të rinj të jenë të trajnuar .						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrument i matës	Vendnd odhja

1	Orë të hapura mësimore, shkëmbim eksperiencash në të gjitha kualifikimet profesionale	Gjatë vitit Janar –Maj 2024	Drejtoria Njësia Zhvillimit Ekipet lëndore dhe departamentet, mësimdhënësit	Vëzhgim, diskutim	Realizim, kontroll Performanca e lartë në mësimdhënie	Shkollë
2	Trajnim profesional në lidhje me faktorët që ndikojnë në mësimdhënie dhe mësimnxënie	Gjatë gjithë vitit 2024	N/Drejtor i Njësia zhvillimit Mësimdhënës	Takime të drejtëpërdrejta	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënësit. Çertifikimi	Shkollë Njësi Zhvillimi Sipas organizimit

REKOMANDIMI 2		-Zbatimi i fazave dhe i kohës së përcaktuar gjatë orës mësimore për arritjen e rezultateve mësimore në fund të saj.				
Objektivi		-Të përcaktohet koha e fazës të orës mësimore.				
Treguesi i përmbushjes: Arritja e rezultateve të të nxënës.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrumen ti matës	Vendn dodhja
1	Orë të hapura mësimore.	Prill 2025	Departamentet ,mësimdhënësit	Vëzhgim, diskutim	Realizim, kontroll Performanca e lartë në mësimdhënie	Shkollë
2	Biseda , diskutime me mësimdhënësit .	Shkurt –Maj 2025	N/Drejtor ia. Njësia zhvillimit Mësimdhënës	Takime të drejtëpërdrejta	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënësit.	Shkollë Njësi Zhvillimi Sipas organizimit

REKOMANDIMI 3		-Përmirësimi i lidhjes harmonike midis koncepteve dhe aftësive kryesore të nxënësve me ndihmën e mësimdhënësit.				
Objektivi		- Të identifikohen aftësitë kryesore të nxënësve dhe tu krijohet mundësia për t'u zhvilluar këto aftësi.				

Treguesi i përmbushjes: Rezultatet e nxënësve .						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrument i matës	Vendn dodhja
1	Trajnim i mësimdhënësve nëpërmjet rrjeteve profesionale që të derivojnë me njëra – tjetrën.	Gjatë vitit 2025	Stafi drejtues NJ.Zhvili mit	Trajnime, takime , Shkëmbime Përvojash dhe aftësish.	Listëprezencë Dokumentacioni përkatës	Shkollë
2	Projekte të ndryshme lëndore dhe ndër-lëndore ku të zhvillohen aftësitë e nxënësve.(Ditët e hapura)	Gjatë vitit 2025	Stafi drejtues Stafi mësimdhënës NJ.Zhvili mit	PNP Puna në grup	Librat Mjetet mesimore	Shkollë
3	Aktivitete të ndryshme në shkollë ku shpaloset aftësia e nxënësve	Gjatë vitit 2025	Senati Psikologu NJ.Zhvilli mit	Pune projekte e grupe.	Dosjet e personave përgjegjës .	Shkollë

REKOMANDIMI 4		-Përmirësimi i metodologjisë së mësimdhënies duke përfshirë teknika dhe strategji bashkëkohore.				
Objektivi		<p>- Të përmbushen rezultatet e të nxënësve sikur janë të përcaktuara në planin ditor.</p> <p>- Të motivohen nxënësit me nevoja veçanta duke përdorur strategji gjithëpërfshirëse.</p>				
Treguesi i përmbushjes: 1. 100% e mësimdhënësve të jenë të trajnuar për bazat e didaktikës mesimore 2. I gjithë stafi mësimdhënës të njohë dhe zbatojë metodologjinë e mësimdhënies.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrument i matës	Vendn dodhja
1	Vëzhgime gjatë procesit mësimor (Orë mesimore dhe projekte lëndore)	Shkurt -maj 2025	Stafi drejtues	Vëzhgim	Shënimet e drejtuesit Plani vëzhgimit	Shkollë
2	Detyra të lira të pavarura, ku nxënësit me nevoja të veçanta të shprehin ndjesitë dhe aftësitë e tyre në klasë dhe jo vetëm.	Shkurt -maj 2025	Mësimdhënësit	Strategji gjithëpërfshirëse.	Produktet e nxënësve të afishuara	Shkollë

FUSHA E VETËVLERËSIMIT : Vlerësimi .

REKOMANDIMI 1	Mësuesit në çdo rast të vlerësimit të nxënësve duhet të informojnë prindërit dhe nxënësit për metodologjinë e përdorur dhe rezultatet e arritura.
----------------------	---

Objektivi		<i>-të informojnë prindërit dhe nxënësit rregullisht për mënyrën e përfitimit të krediteve dhe të pikëve.</i>				
Treguesi i përmbushjes: Informimi i prindërve me mënyrën e përfitimit të krediteve dhe pikëve për vlerësimin e nxënësve me notë.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrument i matës	Vendndodhja
1	Takimet me prindër sipas tremujorëve	Mars, Qershor 2025	Mësuesit kujdestarë	Takime të drejtëpërdrejta	Relacion	Klasa Laboratore. Repartete.
2	Rishikimi i fletëve informuese të prindërve (me pikë dhe me kredite)	Shkurt - 2025	Drejtori, sekretari Koord.Kurrikulës Mësues kujdestarë	Hartimi i fletëve	Fletët informuese	Shkollë Sekretari

REKOMANDIMI 2		<i>-Përmirësimi i metodave për vlerësimin sa më objektiv të arritjeve të nxënësve.</i>				
Objektivi		<i>-Të përmirësohen edhe me tej metodat për vlerësimin sa më objektiv të arritjeve të nxënësve.</i>				
Treguesi i përmbushjes: Trajnimi i mësimeve me fokus përmirësimi dhe përdorimi i metodave të vlerësimin të arritjeve të nxënësve.						
Nr	Veprimtaritë	Afate kohore	Personi përgjegjës	Metodologjia	Instrument i matës	Vendndodhja
1	Kualifikim i brendshëm: -Trajnim i mësimeve për metodat e vlerësimin të arritjeve të nxënësve	Mars - 2025	Kryetarët e departamenteve	Takim i drejtëpërdrejta	Listëprezencë	Shkollë
2	Kualifikim i brendshëm: -Orë të hapura mësimore në të gjitha kualifikimet profesionale me fokus: "Metodat e vlerësimin të nxënësve"	Prill 2025	N/Drejtori i shkollës Departamentet dhe ekipet lëndore	Vëzhgim, diskutim Pyetësore Intervista	Relacion i hapur	Klasa, Laboratore. repartete

Ekipi përgjegjës i vetëvlerësimin

Kryetari
Nazmi Kasmi



Anëtare
Mimoza Zhamo



Anëtare
Etleva Kacanja

